



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.09, datë 02.07.2024

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“AMBIENTE NDIHMËSE DHE TEKNIKE 1 KAT MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË”,**  
**SI DHE SISTEMIMI NË OBJEKTIN E XHAMISË SË PLUMBIT,**  
**ME VENDNDODHJE NË BASHKINË SHKODËR**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Drejtorinë e Përgjithshme e Fondacioneve të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit të Republikës së Turqisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ambiente ndihmëse dhe teknike 1 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, si dhe sistemimi në objektin e Xhamisë së Plumbit, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër, me subjekt zhvillues Drejtorinë e Përgjithshme e Fondacioneve të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit të Republikës së Turqisë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko - ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shkodër.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI  
E DI RAMA

MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
BLENDI GONXHEJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 08 / 10 / 2024